

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL VITI**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **657-26-3468-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtja e objekteve komunale, shëndetsore dhe arsimore të Komunës së Vitisë- Tre vjeqar**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

| | |
|--|-------------------------------|
| Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj | Royal Paper SH.P.K. |
| NUI | 811469023 |
| Adresa | Syle Avdyli |
| Vendi | Ferizaj |
| Kodi postar | 70000 |
| Numri Telefonit | |
| Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj | Xhelal Ademi |
| Adresa elektronike | royalpaperks@gmail.com |
| Data e parashtrimit të ankesës | 11.06.2026 |

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtja e objekteve komunale, shëndetsore dhe arsimore të Komunës së Vitisë- Tre vjeqar

Njoftimi për kontrate 14.05.2026

Dosja e tenderit ndryshime 04.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjate kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim e dates 08.06.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Nenin 28 te LPP-se

Nenin 56 te rregullore për prokurim publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në vazhdim po ju njohim me faktet dhe argumentet që e mbështesin pretendimin tim lidhur për shkeljet e dispozitave të LPP-së nga ana e AK-së.

Pretendimi 1

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së, pasi gjatë procesit të përgatitjes së specifikimeve teknike dhe dosjes së tenderit nuk ka përgatitur specifikime të qarta, ashtu siç kërkohet me nenin 28, paragrafi 8 i LPP-së. Po ashtu, dëshmitë e kërkuara në pikat 9.1 dhe 9.2 janë të paqarta, pasi nuk specifikohet se çfarë dokumenti duhet të ofrohet si dëshmi relevante për të vërtetuar pronësinë e furgonit elektrik apo frezen e dorës për largimin p.sh. nëse mjafton vetëm fotografia apo kërkohet kontrata e shitblerjes, etj.

Mungesa e specifikimit të dokumentacionit lë hapësirë për interpretime të ndryshme dhe krijon mundësi për trajtim diskriminues gjatë vlerësimit të ofertave. Në këto rrethana, komisioni i vlerësimit mund të keqpërdorë diskrecionin e tij dhe të refuzojë oferta për shkak të interpretimeve të ndryshme lidhur me dokumentacionin e kërkuar. Prandaj, mungesa e specifikimit të qartë të dokumentacionit relevant përbën shkelje të nenit 7 të LPP-së.

Provë: Dosja e tenderit, datë 15.05.2026

Pretendimi 2

AK ka shkelur edhe nenin 28 të LPP-së, përkatësisht paragrafin 8 të tij, i cili kërkon që kërkesat ekzekutuese dhe funksionale të jenë të sakta në mënyrë që t'u mundësohet tenderuesve të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe t'u lejohet autoriteteve

kontraktuese të shpërblejnë kontratën.

Në Aneksin 1 të dosjes së tenderit, në specifikimet teknike është kërkuar që të realizohen shërbime pastrimi sipas nevojave të Autoritetit Kontraktues. Megjithatë, askund nuk është përcaktuar kohëzgjatja e një huazimi të makinerve të nevojshme nga ana e Autoritetit Kontraktues. Si operator ekonomik potencial, nuk e kemi të qartë nëse huazimi i makinerve për një shërbim do të zgjasë një ditë, dy ditë, një muaj apo një vit.

Në mungesë të këtij informacioni, është e pamundur të përgatitet një ofertë reale dhe të jepet një çmim i saktë, pasi mungon specifikimi i kërkesave ekzekutuese dhe funksionale. Për rrjedhojë, kjo përbën shkelje të nenit 28, paragrafi 8 të LPP-së.

Bazuar në sipërfaqet dhe natyrën e shërbimit që do të ofrohet të realizuara deri më tani nga Kuvendi Komunal vitia, ato mund të realizohen pa problem pa pasur nevojë që të perdoret freza e dorës për largimin e bores, furgoni elektrik, i cili është model më i ri për të mund të zavendesohet edhe me një pajisje të cilat janë lende djegëse si naftë apo benzinë.

Për më tepër, këto sipërfaqe mund të realizohen pa problem nga një furgon me lëndë djegëse naftë/benzinë e të cilat janë shumë më efektive dhe efikase pasi që nuk kanë nevojë për mbushje dhe nuk janë të varur nga energjia elektrike e cila në Kosovë shpesh ka edhe reduktime.

Prandaj, kërkesa që furgoni të jete vetëm elektrik për të marrë pjesë në këtë procedurë të prokurimit, bazuar në arsyetimet e mësipërme, përbën shkelje të nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke imponuar kushte që rezultojnë në diskriminim material dhe zvogëlim të konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Ne, si operator ekonomik potencial, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të sigurojë pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë të interesuar në këtë procedurë të prokurimit, duke eliminuar praktikën, kriteret dhe kërkesat që diskriminojnë në favor ose në dëm të një apo më shumë operatorëve ekonomikë.

Për hir të parimit të efikasitetit dhe për të shmangur zvarritjen e kësaj procedure në instancën të ndryshme, kërkojmë me respekt nga Autoriteti Kontraktues që kjo pikë e dosjes së tenderit të ndryshohet dhe të plotësohet me sqarimet e nevojshme, duke mundësuar pjesëmarrjen edhe të operatorëve ekonomikë që ofrojnë furgon me lëndë djegëse si naftë/benzinë të cilët arrijnë efekt të njëjtë apo edhe më të mirë se ai i kërkuar në dosjen e tenderit.

Furgoni elektrik, freza e dorës për largimin e bores nuk janë të domosdoshme për realizimin e shërbimit të kërkuar dhe kërkesa për të kufizon konkurrencën, gjë e cila është e ndaluar me LPP.

Pretendimi 3

Siq verehet nga pergjigja e AK-se kemi nje mos trajtim professional per faktin se kerkesa per rishyrtim e dorezuar nga ana jone eshte e afatshme sepse e kemi dorezuar me dt 08.06.2026 e cila eshte dita parafundit per dorezimin e ofertave e jo siq e ka trajtuar AK sit e jashtefatshme. Andaj kerkojm nga OSHP qe ankesen tone ta trajtoj me profesionalizem

Përfundim

Si përfundim, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të plotësojë dhe avancojë dosjen e tenderit, të eliminojë kriteret që krijojnë favorizime dhe imponojnë rrethana diskriminuese, si dhe të shmangë shkeljen e dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik.

Në të kundërtën, dhe pa dëshirën tonë, do të jemi të obliguar t'i drejtohem Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik për mbrojtjen e të drejtave tona ligjore.

Andaj, bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura më sipër, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të ndër marrë masat e nevojshme dhe të vendosë si vijon:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar kërkesa për ankesa e bërë nga Royal Paper SHPK _lidhur me tenderin me titull: **Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtja e objekteve komunale, shëndetsore dhe arsimore të Komunës së Vitisë- Tre vjeqar dhe numer prokurimi 657-26-3468-2-1-1, inicuar nga Kuvendi Komunal Viti**

ANULOHET njoftimi per kontrate dhe dosja e tenderit apo te korigjohet conform njoftimit b53 nga AK- **Kuvendi Komunal Viti**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmi materiale per proceduren ne fjalë eshte 1000euro

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*